



Revista

E KRYQIT TË KUQ SHQIPTAR

Nr. 81 • Viti XXIV i botimit • 2021 • www.kksh.org.al



*Viti 2020,
si asnjë vit tjetër*



ORGAN I KRYQIT TË KUQ SHQIPTAR, SHPËRNDAHET FALAS.

KRYQI I KUQ SHQIPTAR

vepron në të gjithë vendin, nëpërmjet 39 degëve të tij.



Këshilli botues

Redaktori përgjegjës: Zamir Muça



VIZIONI

Kryqi i Kuq Shqiptar synon të jetë një shoqatë humanitare e zhvilluar, që punon për përmirësimin e jetës dhe dinjitetit të njerëzve në nevojë, në përputhje me parimet themelore të Lëvizjes.

MISIONI

Kryqi i Kuq Shqiptar ndihmon, nëpërmjet veprimtarisë së vet humanitare, njerëzit më në nevojë duke mobilizuar forcën e humanizmit të shoqërisë shqiptare.

Pasqyra e lëndës

Viti 2020, si asnjë vit tjetër	3
Pas tërmetit, një tjetër operacion i madh ndihme për familjet në nevojë të prekura nga COVID-19	4
Bashkë do ja dalim!	6
Vullnetarizmi, ndryshimi që rikrijon pozitivisht njeriun dhe shoqërinë...!!!	8
Teknika e manipulimeve më të shpeshta të ndihmës urgjente mjekësore	12
Roli i pabesueshëm i Lëvizjes ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe gjatë Luftës së II Botërore	14
Veprimtaritë e Kryqit të Kuq Shqiptar	16

Lutemi që artikujt, materialet apo kërkesat për informacion, t'i dërgoni në adresën:

Kryqi i Kuq Shqiptar, Rr. "Pjetër Budi, Ndërtesa 19", Kutia Postare 1511, Tiranë

Recepsioni: + 355 4 2 257 532 **Tel/Fax:** + 355 4 2 225 855 + 355 4 2 222 037 **Email:** kksh@kksh.org.al **Faqja në internet:** <http://www.kksh.org.al>

Redaksia falënderon të gjithë anëtarët, vullnetarët, të punësuarit në KKS dhe bashkëpunëtorët jashtë tij, për ndihmën e dhënë në nxjerrjen e këtij numri të revistës. Revista e Kryqit të Kuq Shqiptar del tri herë në vit në një tirazh prej 1500 kopje. • Revista shpërndahet falas. • Opinione dhe shprehura janë përgjegjësi e autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht opinionin e Kryqit të Kuq Shqiptar. Çdo artikull i dërguar, por jo i kërkuar është i mirëpritur, por nuk do të kthehet. • Redaksia rezervon të drejtën që të redaktojë artikujt. Artikujt dhe fotografitë që nuk i nënshtrohen të drejtës së autorit mund të rishkruhen pa një autorizim paraprak, lutemi citoni Kryqi i Kuq Shqiptar. • Shkrimet e publikuar në këtë revistë kanë një vlerë tërësisht informative dhe janë të zhveshura nga çdo lloj nënkuptimi tjetër.

Viti 2020, si asnjë vit tjetër



Maj. Ylli Alushi,
President i Kryqit të Kuq Shqiptar



Viti që lamë pas rezultoi më i veçanti në kuptimin e plotë të fjalës për shoqatën e Kryqit të Kuq Shqiptar në këto tri dekadat e fundit. Nisi si i veçantë, me vazhdimin e aktiviteteve të planifikuara për t'iu përgjigjur nevojave të familjeve më të dëmtuara si rezultat i pasojave të tërmetit të fund nëntorit 2019, si një përvojë e re kjo dhe e panjohur për shoqatën, kur marrim si pikë referimi momentin e riorganizimit të saj afro tri dekada më parë dhe, brenda tremujorit të parë vijoi të përballlej edhe me situatën e pandemisë, krijuar nga përhapja e virusit Sars-Cov2, e cila kishte njohur shpërthimin e saj në fillim të dhjetorit 2019 në një qytet të Kinës kontinentale dhe që brenda pak muajsh u përhap në çdo skaj të globit. Edhe kjo një situatë e panjohur për shoqatën, duke bërë kështu që ky vit të rregjistrohet në arkivin e historisë së saj si viti më i veçantë.

Në fakt shoqata është formuar për të qenë gati për të ofruar kontributin e saj në favor të më nevojtarëve në rast të një katastrofe natyrore por, nuk ishte menduar

Speciet që i kanë mbijetuar kohërave nuk kanë qenë as ato me të fortat e as ato më të zgjuarat, por ato që kanë mundur t'u përshtaten ndryshimeve. —Charles Darwin

ndonjëherë që përballja e shoqatës do të ishte me dy emergjenca njëherazi, tërmeti dhe pandemia. Dy fatkeqësi brenda një harku kohor tre mujor nuk kishin ndodhur ndonjëherë në vendin tonë dhe, për ironinë e këtij fati, njëra prej tyre, pandemia, sikur të mos mjaftonte me vështirësitë që bartte, por godiste dhe në pikën më të fortë të shoqatës, në aftësitë e saj në organizimin dhe përmbushjen e aktiviteteve nëpërmjet aksionit humanitar të vullnetarëve. Kontakti fizik ndërmjet njerëzve do të rezultonte si një nga rrugët kryesore të përhapjes së pandemisë. Më keq nuk mund të ndodhte.

Dukuritë e natyrës, të cilat sjellin si pasojë dëme të mëdha në jetën e njeriut dhe infrastrukturën e ngritur prej tij, nuk mund të frenohen nga njeriu. Ato janë shfaqje të mënyrës se si ekziston vetë natyra, duke qenë fenomene të zakonshme të saj. Kështu, të ftohtit e acartë, thatësira, tërmetet, përmytjet, tsunamet, ciklonet, epidemitë, etj., kanë qenë bashkëshoqëruese të njeriut që me shfaqjen e tij mbi tokë. Kushti i parë i njeriut për t'u mbijetuar këtyre fatkeqësive, nis nga vetëpërmbytja dhe orientimi drejt i tij me situatën e krijuar dhe më pas vijohet me organizimin e përpjekjeve të tij për t'u përballur me to, për të mundur kështu një reagim në proporcion të drejtë më atë që ka ndodhur. Ajo që ka mundur të bëjë njeriu lidhet me marrjen e një serë masash me karak-

ter parandalues të pasojave shkatërruese që sjellin këto dukuri. Pjesë e këtyre masave është dhe aksioni humanitar i organizuar nga ente të ndryshme shtetërore e private në mbarë botën që planifikojnë dhe venë në jetë në momentin kur goditen nga këto dukuri shkatërruese.

Kështu ndodhi dhe me shoqatën tonë. Ajo u orientua drejt me situatën e krijuar, planifikoi hapat që duhet të ndërmerre dhe pas mobilizimit të resurseve të saj dhe atyre të donatorëve, u hodh në veprim. Gjatë gjithë vitit u punua në të dy frontet; në përballjen me pasojat e tërmetit dhe me përpjekjet për parandalimin dhe lehtësimin e pasojave që krijonte në çdo moment pandemia.

Këto dy fatkeqësi goditën vendin në momentin kur shoqata po hynte në vitin e fundit të planit të saj strategjik, dhe kur i duhej të përballlej me realizimin e objektivave të parashikuara në Strategjinë e viteve 2016-2021. Pikërisht në këtë moment asaj iu desh të ndryshonte pothuaj tërësisht drejtimin e aktiviteteve të saj, duke u fokusuar në këto dy fronte të vështira për shpatullat ende të paformuara si duhet të saj.

Dy fatkeqësi njëherazi padyshim që përbëjnë një sfidë të pazakontë dhe të vështirë edhe për shoqatat simotra të vendeve më të zhvilluara e të fuqishme të globit dhe me më shumë përvojë. Por shoqata e

vijon në faqen 18

Pas tërmetit, një tjetër operacion i madh ndihme për familjet në nevojë të prekura nga COVID-19

Jetojmë në situatë pandemie. Madje në katër mujorin e fundit shtator-dhjetor 2020, situata është përkeqësuar me shtim të rasteve të prekura dhe me humbje jete. Deri në 31 dhjetor 2020 janë regjistruar 58 316 raste pozitive, 1181 persona kanë humbur jetën, ndërkohë që janë regjistruar 33634 persona të shëruar.

E sigurisht që në këto kushte, nga instancat përkatëse u morën masa të tjera mbrojtëse si: ndalimi i grumbullimit të njerëzve jo më shumë se 10 persona, detyrimi për mbajtjen e maskës, respektimi i distancës ndërmjet njëri tjetrit dhe kufizimi i lëvizjes së njerëzve sipas orareve të përcaktuara.

Për shkak të Covid-19 binomi shkak-pasojë ka prekur të gjitha fushat e jetës: ekonomia është në

vështirësi mbasi shumë biznese punojnë me orar të reduktuar ose janë mbyllur fare; edukimi është cunguar mbasi shkollat dhe universitetet janë mbyllur dhe funksionojnë online; institucionet e ndryshme shtetërore dhe private punojnë me orar të reduktuar ose online; shëndeti është prekur sepse është shtuar stresi dhe përkeqësuar gjendja psiko-sociale e njerëzve për shkak të kufizimeve të lëvizjes së lirë të njerëzve; varfëria është shtuar dhe më shumë për shkak të mbylljes së vendeve të punës dhe rritjes së papunësisë, etj.

Duke patur parasysh këtë situatë, veçanërisht shtimin e numrit të familjeve në nevojë dhe përkeqësimin e gjendjes së vështirë ekonomike për një numër të konsiderueshëm personash, Kryqi i Kuq Shqiptar ka vazhduar operacionin

e ndihmës së filluar që në muajin mars 2020. E për këtë është kërkuar nga shoqata, rishikimi i Apelit për emergjencën Covid-19 në Federatën Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe. (Federata ndërkombëtare) Falë përpjekjeve të dyanshme fondi i operacionit të ndihmës u shtua me 350 mijë CHF të tjera, duke e çuar shifrën e Apelit të ndihmës në 465 mijë CHF. Ky ndryshim solli dhe shtyrjen e afatit të përfundimit të këtij apeli nga 20 dhjetori më 31 mars 2021.

Operacioni i rishikuar i emergjencës për Covid -19, me Federatën Ndërkombëtare është i organizuar në tri drejtime kryesore:

- Ndhimë me pako standarde ushqimore dhe kite higjienike (maska, dezinfektues, sapun, shampo, etj.) për 2000 familje të tjera për 1 muaj;
- Ndhimë financiare CASH për 2 000 familje, (Bonus financiar) ku një familje do të përfitojë një shumë prej 12 000 lekë;
- Mbështetje psiko-sociale për komunitetet e prekura nga pandemia.

Kështu, në zbatim të këtij operacioni emergjence, Selia po ndihmon të 38 degët e saj, gjithnjë duke patur në konsideratë nivelin e degës. Konkretisht:

- Degët e vogla dhe të mesme do të mbështetin 30 familje me bo-





nus financiare (12 000 lekë secila) dhe 40 familje të tjera me ndihma ushqimore dhe kite higjienike (sipas standardit të Kryqit të Kuq);

- degët e mëdha do të ndihmojnë 100 familje me bonusin financiar prej 12 000 lekë, dhe 80-90 familje të tjera me pako ushqimore dhe kite higjienike. Ndërsa Dega e Kryqit të Kuq Tiranë do të ndihmojnë 120 familje me bonusin financiar dhe 150 familje me pako ushqimore dhe kite higjienike.

Për shumë prej degëve, mbështetja e familjeve në nevojë me bonusin financiar është një projekt i ri që realizohet për herë të parë. Realizimi në praktikë i këtij projekti, kërkoi një trajnim të stafit dhe vullnetarëve që do të angazhoheshin për mënyrën e realizimit në praktikë të saj. 115 persona (një ekip prej tre personash nga secila degë, sekretari dhe dy vullnetarë) u njohën me projektin, duke u fokusuar veçanërisht në zbatimin në praktikë të sistemeve on-line, "Kobo system" të Federatës Ndërkombëtare, sistem ky që realizon në praktikë vlerësimin e familjeve në nevojë përfituese nga ky projekt.

Dy fjalë për projektin: familjet në nevojë përfituese duhet të përmbushin disa kriteret: të jenë familje me asistencë sociale; familje me kryefamiljare femër; familje me persona të infektuar me Covid, etj.

Praktikisht, përzgjedhja e familjeve që do të përfitonin bonusin financiar do të dilnin nga listat e familjeve përfituese që degët e Kryqit

të Kuq kanë ndihmuar gjatë këtij viti. Pikërisht nga listat e hartuara përzgjidhen sipas nivelit të degës, 30, 40 ose 100 familje, familje këto që përmbushin kriteret e mësipërme. Pas evidentimit dhe regjistrimit të familjeve më në nevojë dhe vlerësimit të tyre derë më derë, të dhënat përcillen online në sistemin Kobo në Gjenevë, i cili bën dhe vlerësimin përfundimtar të listës.

Mekanizmi i shpërndarjes është me Çek bankar nëpërmjet Raiffeisen Bank. Masa e përfitimit për çdo familje është 12 000 lekë të reja pavarësisht nga numri i anëtarëve. Përgatitja e çeqeve bëhet nga selia dhe shpërndahen nëpër degë. Ndërkohë që disa degë organizonin procesin e vlerësimit të familjeve në nevojë, në disa degë të tjera ku është kryer ky proces, është vazhduar me shpërndarjen e çeqeve dhe ekzekutimin e tyre në bankë. Mbështetja financiare e familjeve në nevojë do të duhej të përfundonte më datë 15 mars 2021.

Pjesë e operacionit të ndihmës për familjet e prekura më shumë nga Covid-19 është dhe shpërndarja e ndihmave ushqimore dhe kiteve higjienike sipas standardit të Kryqit të Kuq për 2000 familje në të 38 degët e shoqatës. Pakoja ushqimore e ndihmës përbëhet nga: 10 kg miell, 4 kg fasule, 4 kg makarona, 4 litra vaj, 4 kg oriz, 4 kg sheqer dhe 0.5 kg kripe; kiti higjienik përbëhet nga: 10 maska, 1 litër dezinfektues për duar, 2.5 litra dezinfektues sipërfaqesh,

1 litër sapun i lëngshëm, 2 shampo, dhe 5 copë sapun.

Me operacionin e fundit të ndihmave, numri i familjeve të ndihmuara nga fillimi i pandemisë nga operacioni i emergjencës shkon në 7 900 familje me pako ndihme standard dhe 2 000 familje me bonusin financiar.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm i këtij operacioni të gjerë ndihme për familjet në nevojë të prekura nga pandemia Covid-19 është dhe mbështetja psiko-sociale aq e nevojshme në këto ditë të vështira pandemie. Me eksperiencën e fituar në operacionin e ndihmës të organizuara për shkak të tërmetit në këtë fushë, ekipet e trajnuara të përbëra nga staf dhe vullnetarë japin mbështetjen e tyre në veprimtaritë e organizuara në terren për të gjithë individët në nevojë.

Ndërkohë, vazhdon komunikimi nëpërmjet linjës së gjelbër të telefonit pa pagesë 08008833 ku individë në nevojë kërkojnë ndihmë ose ngrenë shqetësimet e tyre dhe ku stafi i KKSHT-së jep përgjigje rast pas rasti. Në këtë komunikim është dhënë mbështetje psiko-sociale për personat të cilët kanë shfaqur probleme të shëndetit mendor.

Në ndihmë të mbështetjes psiko-sociale të organizuar nga stafi dhe vullnetarët është dhe përgatitja dhe shpërndarja e 3 fletëpalosjeve me informacion bazë për masat në mbrojtje nga pandemia për vullnetarët, komunitetin dhe fëmijët.

Jemi në kohë pandemie, prandaj të gjitha veprimtaritë e Kryqit të Kuq kryhen në zbatim të masave të rrepta dhe protokolleve shëndetësore, si mbajtja e maskës, respektimi i distancës dhe higjiena personale si për stafin ashtu dhe vullnetarët.

Fatos Xhengo

Koordinator i Programit të Përgatitjes dhe Ndërhyrjes në raste Katastrofash dhe Ndihma e Parë

Bashkë do t'ia dalim!



Vitit 2020, viti që sapo kaloi, ishte një vit i vështirë për të gjithë, një vit që na përballi me situata të vështira që prekën shëndetin, ekonominë, punën, shkollimin e fëmijëve, izolimin fizik dhe atë social.

Si një nga aktorët kyç të fushës humanitare në vend, Kryqi Kuq Shqiptar vazhdoi punën e nisur që pas tërmetit të vitit 2019, në mbështetje të familjeve në nevojë për zbutjen e pasojave sociale dhe ekonomike të përkeqsuara ndjeshëm nga pandemia. Dhe pse COVID-19 pati ndikim të dukshëm në veprimtaritë e shoqatës dhe imponoi si kudo sfida në realizimin në praktikë të veprimtarive humanitare, KKSHT ka bërë të mundur ndihmën e rreth 41,000 persona në të gjithë vendin.

Periodha e festave të fund vitit ishte një periudhë e vështirë, veçanërisht për familjet që kanë humbur të dashurit e tyre, kanë përjetuar përkeqësim të shëndetit, të të ardhurave, kanë humbur punën dhe mundësitë për të festuar janë pothuajse të pamundura.

Dhe pse të kufizuara në veprimtaritë e tyre për shkak të pandemisë, degë të Kryqit të Kuq kanë qenë pranë njerëzve në nevojë. Kështu dega e Kryqit të Kuq Tiranë ka mbështetur rreth 300 familje në nevojë, 150 prej tyre falë një donacioni të Big Market, Dega e KK Lezhë ka mbështetur 50 familje, Dibër 11 familje, Elbasan 30 familje, Korçë 25 familje. Ndihej është ofruar për familje më në nevojë, duke u dhënë prioritet të moshuarve të vetmuar apo familjeve me shumë fëmijë e pak të ardhura.

Mbështetja e familjeve më në nevojë ka vazhduar dhe në periudhën nëntor-dhjetor, si në Degën e Kryqit të Kuq, Tiranë ku janë mbështetur 90 familje me paketa ushqimore dhe artikuj higjienikë, në Korçë janë ndihmuar me veshmbathje, kite higjienike 50 banorë të qendrës rezidenciale të personave me aftësi ndryshe dhe një mbështetje në veshmbathje dhe pajisje të ndryshme për 20 fëmijë të shtëpisë së foshnjës, në Shkodër janë mbështetur 100 familje, ndërsa në Skrapar

janë mbështetur 24 familje me fëmijë jetim, në Vlorë është ofruar ushqim i ngrohtë për 63 të moshuar dhe të pastrehë, në Shkodër ka vazhduar mbështetja ushqimore dhe vizitat në shtëpi nga ekipet e vullnetarëve për 20 të moshuar të vetmuar, duke ruajtur kontakte të vazhdueshme me ata të moshuar që jetojnë vetëm, me qëllim ofrimin e shërbimeve të tilla si blerja e sendeve të nevojshme dhe ilaçeve, me qëllim minimizimin e daljeve të tyre dhe shmangien e kontakteve të panevojshme.

Përjetime të vullnetarëve që nuk shlyhen lehtë nga veprimtaritë e përditshme humanitare – Dega e Kryqit të Kuq Shkodër

✚ Angazhimi imë në Kryqin e Kuq, është i lidhur me dëshirën për të ndihmuar njerëzit të nevojë dhe në vështirësi për patur një jetë normale. Dëshira për t'iu bërë krah më të dobët, m'u realizua më së miri në këtë shoqatë, ku së bashku me vullnetarët e tjerë herë pas here na jepet mundësia të tregojmë që grupet në nevojë nuk janë vetëm dhe të pashpresë.

E krahas ndihmave të dhëna, nuk është lënë pas dore mbështetja psiko-sociale, aq e nevojshme në kushtet e një pandemie.

Ndryshe nga vitet e tjera, viti 2020 u bë dhe më i vështirë për të gjithë, veçanërisht për më të varfrit, ku kriza rëndoi më shumë. Veçmas vështirësive të zakonshme me të cilën ata përballen zakonisht, tashmë dhe rreziku i infektimit dhe pamundësia për t'u kujdesur për shëndetin e tyre.

Për këtë arsye, këtë vit i qëndruam më pranë kësaj kategorie. Së bashku me ekipin e vullnetarëve të



Programit Social, bëmë vizita në shtëpitë e të moshuarve që jetojnë vetëm, familjeve që kanë fëmijë jetim ose me sëmundje të rënda, etj. Të gjitha familjet na presin ngrohtë dhe na urojnë, por nga këto më ka mbetur në mendje Zyhraja në një rast. E moshuar mbi 70 vjeçe, e kërrusur nga mundimet e viteve, e cila me aq pak energji që i ka mbetur mundohet çdo herë të na qerasë me çfarë i gjendet në shtëpi dhe nuk ndalet duke na falënderuar. Ditën

që ishim në shtëpinë e saj në fshatin Zues, duke parë pakot që po i ulnim nga makina, Zyhraja me zërin e saj që mezi i dëgjohet nga problemet shëndetësore, na tha: "Unë për momentin kam pak ushqime se më kanë dhënë të afërmit, shikoni se ndoshta ka ndonjë që është më në hall se unë."

Ishte diçka që nuk e kishim dëgjuar më parë nga askush. U larguam nga nënë Zyhraja me bindjen se në varfëri mungojnë shumë gjëra,

por kanë diçka që nuk do të mungojë kurrë: zemërgjerësia dhe dhembshuria për të tjerët.

✚ Një vajzë e re në moshë e sapo punësuar në një supermarket, nëpërmjet një vullnetari të degës, me dëshirën dhe iniciativën e saj, mori kontakt me degën e Kryqit të Kuq Shkodër.

Nuk është vullnetare e degës, por pas gjestit të saj do të jetë patjetër. Ajo ofroi ushqime dhe produkte të tjera të konsumit familjar të mjaftueshme për një muaj, për një familje në nevojë. Dhe e gjitha kjo nga kursimet e veta.

"Paketa e ndihmës" nuk ishte me destinacion të paracaktuar, ajo duhet të ishte për një nga familjet në nevojë e identifikuar nga Kryqi i Kuq.

Vajza nuk pranoi të identifikohet as për publikun dhe as për familjen që do të ndihmohej. E vetmja dëshirë e shprehur ishte që familja përfituese duhet të ishte në nevojë, prandaj kishte zgjedhur Kryqin e Kuq. Një dëshirë sigurisht e plotësuar.

Një shembull që nuk është i vetëm, por i bërë nga një vajzë e re është shumë domethënës.



Zhaneta Kala

Koordinatorë e Programit Social

Vullnetarizmi, ndryshimi që rikrijon pozitivisht njeriun dhe shoqërinë...!!!



Prof. Dr. Përparim Kabo

E hapur për të gjithë, dhe në shërbim të publikut të gjerë, Revista e Kryqit të Kuq Shqiptar ka mirëpritur prej kohësh kontributin e personaliteteve të fushave të ndryshme, në fusha me interes të veprimitarisë humanitare të tij. Në këtë numër të revistës, kemi nderin të prezantojmë një shkrim të Prof. Dr. Përparim Kabo për vullnetarizmin... që padyshim është një vlerë e shtuar për Revistën e Kryqit të Kuq Shqiptar.

Bashkuara, e ndjekur shtatë vjet më vonë nga YYCA (Young Women's Christian Association) e parë. Gjatë Luftës Civile Amerikane, gratë dolën vullnetare për të dhuruar kohën e tyre dhe ato shërbyen për të qepur rrobat si furnizime për ushtarët. "Engjëlli i Fushës së Betejës" Clara Barton dhe një ekip vullnetarësh filluan të siguronin ndihmë për ushtarakët. Barton themeloi "Kryqin e Kuq" Amerikan në vitin 1881 dhe filloi mobilizimin e vullnetarëve për operacionet e ndihmës ndaj katastrofave, përfshirë ndihmën për viktimat e përmbytjes në Johnstown në 1889.

Në Shekullin e 20-të nga gjithë bota erdhën vullnetarë në Itakë, për të ndihmuar në një epidemi të gripit përmes Korpuseve të Urgjencës së Grave (më vonë Rezervat Vullnetare të Grave). Kjo ngjarje ndodhi në korrik 1919.

Ushtria e Shpëtimit është një nga organizatat më të vjetra dhe më të mëdha që punoi për njerëzit në nevojë. Megjithatë është një organizatë bamirësie, ajo ka organizuar një numër programesh

vullnetare që nga fillimi i saj. Para shekullit të 19-të, disa organizata zyrtare bamirësie ekzistonin për të ndihmuar njerëzit në nevojë. Në dekadat e para të shekullit XX-të u themeluan disa organizata vullnetare, duke përfshirë "Rotary International," "Kiwanis International," "Association of Junior League International & Lions Clubs International." Depresioni i Madh ekonomik i viteve '30-të të shekullit XX-të shpërfaq një nga përpjekjet e para në shkallë të gjerë, mbarëkombëtare, për të koordinuar vullnetarizmin e adresuar kjo ndihmë për një nevojë specifike. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, mijëra "zyra vullnetarësh" mbikëqyrën vullnetarët që ndihmuan njerëzit në nevojë, më së shumti forcat e ushtrisë në front, duke përfshirë mbledhjen e furnizimeve, argëtimin e ushtarëve me leje dhe kujdesin për të plagosurit. Pas Luftës së Dytë Botërore, njerëzit e zhvendosën fokusin e pasioneve të tyre altruiste në hapsira të tjera, duke përfshirë ndihmën për të varfërit dhe vullnetarizmin jashtë shtetit.

Fjala vullnetarizëm u regjistrua për herë të parë në vitin 1755. Ajo rrjedh nga emri vullnetar, që u lidh aso kohe me shërbimin ushtarak, dhe qe mori shkas nga akti i një vullnetari nga Franca qëndrore. Ndërsa në kuptimin jo-ushtarak, fjala u regjistrua për herë të parë, gjatë viteve 1630 pra ka përdorim më të hershëm dhe përkon me frazën; **"shërbim ndaj komunitetit."** Në një kontekst ushtarak, një ushtri vullnetare është një organizëm ushtarak, ushtarët e të cilit zgjedhin të hyjnë në shërbim falas, (në krahasim me ata që ishin rekrutuar) si vullnetarë të tillë që nuk punojnë "falas", por atyre u jepet paga e rregullt.

Në Shekullin e 19 Amerika përjetoi **"Zgjimën e Madhë."** Njerëzit u bënë të vetëdijshëm për personat në nevojë dhe e kuptuan shkakun e lëvizjes kundër skllavërisë. Në 1851, filloi YMCA (Young Men's Christian Association) e parë në Shtetet e

Clarissa Harlowe Barton (25 dhjetor 1821 - 12 prill 1912) ishte një infermiere pioniere amerikane e cila themeloi Kryqin e Kuq Amerikan. Ajo ishte një infermiere në spital në Luftën Civile Amerikane, një mësuese dhe një nëpunëse e patentave. Meqenëse arsimit për infermierinë nuk ishte zyrtarizuar shumë dhe ajo nuk ndoqi shkollën e infermierisë, ajo ofroi kujdes infermierie të vetë-mësuar. Barton është shquar për të bërë punë humanitare dhe avokati për të drejtat civile në një kohë kur gratë nuk e kishin të drejtën e votës. Ajo u fut në Sallën Kombëtare të Grave të shquara në vitin 1973.

Një zhvillim i madh ishte krijimi i Korpusit të Paqes në Shtetet e Bashkuara në vitin në 1960. Kur Presidenti Lyndon B. Johnson shpalli një Luftë kundër Varfërisë në 1964, mundësitë për shërbime vullnetare filluan të zgjerohen dhe vazhduan me vrull edhe në dekadat e ardhshme. Procesi për gjetjen e punës vullnetare u zyrtarizua, me prarinë e më shumë qendrave të vullnetarëve që formuan edhe mënyra të reja për të gjetur punë, të cilat u shfaqen si kontribute humane në Rrjete të ndryshme Botërore. Sipas Korporatës për Shërbimin Kombëtar dhe Komunitar (në vitin 2012), rreth 64.5 milion Amerikanë, ose 26.5 përqind e popullsisë së rritur, dhanë 7.9 miliardë orë shërbim vullnetar me vlerë 175 miliardë dollarë. Kjo llogaritet në rreth 125–150 orë në vit ose 3 orë në javë me një normë prej 22 dollarë në orë. Në vitin 1960, pasi mbaroi e ashtuquajtura luftë revolucionare në Kubë, Ernesto Che Guevara krijoi konceptin e punës vullnetare. Ajo u krijua me qëllimin që punëtorët në të gjithë vendin të punojnë vullnetarisht disa orë punë në qendrat e tyre të punës. Vullnetarizmi nuk lindi vetëm si një reagim ndaj një thirrje kur situata është e tillë që e lyp këtë shërbim. Vullnetarizmi si vetëdije edukohet dhe një formim i tillë botëkuptimor duhet të nisi që me edukimin familjar dhe me atë të edukimit shkollor. Ka eksperiencat e cilat duhen njohur dhe ku mund të merret shëmbulli referues.

Shumë shkolla në të gjitha nivelet e arsimit në SHBA ofrojnë programe të të mësuarit të shërbimeve, që lejojnë studentët t'i shërbejnë komunitetit përmes vullnetarizmit, ndërsa për këtë kontribut komunitar ata fitojnë kredite mësimore. Sipas Alexander Astin, specialist i këtij lloji edukimi, në parathënien e studimit të titulluar "Ku është vlera në mësimin e shërbimit? ...

e shkruajtur nga Janet Eyler dhe Dwight E. Giles, Jr., lexojmë: "... **ne promovojmë adoptimin më të gjerë të mësimin të shërbimit në arsimin e lartë sepse e shohim atë si një mjet të fuqishëm për përgatitjen e studentëve për t'u bërë prindër dhe qytetarë më të kujdesshëm dhe të përgjegjshëm. Kështu për të ndihmuar kolegjet dhe universitetet për të bërë premtimin e tyre për t'i "shërbyer shoqërisë"..." të mësuarit e shërbimeve karakterizohet nga një marrëdhënie partneriteti: **studenti mëson nga agjencia e shërbimit dhe nga komuniteti dhe, si kthim, jep energji, inteligjencë, angazhim, kohë dhe aftësi për të adresuar nevojat njerëzore dhe të komunitetit.**" Vullnetarizmi në shërbimin e të mësuarit duket se ka rezultatin e angazhimit të mendjes dhe zemrës, duke siguruar kështu një përvojë më të fuqishme të të mësuarit; sipas Janet Eyler dhe Dwight E. Giles, vullnetarizmi ka sukses për faktin se "... ai nxit zhvillimin e studentëve duke kapur interesin e studentëve..." Ndërsa nuk njihet nga të gjithë si një qasje legjitime, hulumtimi mbi efikasitetin e të mësuarit të shërbimit është rritur. Autorët Janet Eyler dhe Dwight E. Giles zhvilluan një studim kombëtar të studentëve të kolegjit amerikan**

për të konstatuar rëndësinë e programeve të të mësuarit të shërbimit. Sipas Eyler dhe Giles, "Këto son-dazhe, të kryera para dhe pas një semestri të shërbimit komunitar, shqyrtuan ndikimin e të mësuarit të shërbimit tek studentët." Ata përshkruajnë përvojën e tyre me studentët e përfshirë në të mësuarit e shërbimit në këtë mënyrë:

"Studentët që mësuan si të shërbejnë." Kur ulemi me një grup studentësh për të diskutuar përvoja të të mësuarit të shërbimit, entuziazmi i tyre është i pagabueshëm ... është e qartë se [studentët] besojnë se çka ata fitojnë nga të mësuarit e shërbimit ndryshon cilësisht nga ato mësimet që shpesh rrjedhin nga udhëzimet më tradicionale."

* * *

Cilat janë tiparet e vullnetarizmit?

Vullnetarizmi i bazuar në tipare po përdor aftësitë e specializuara dhe talentet e individëve për të forcuar infrastrukturën e organizatave jofitimprurëse, duke i ndihmuar ato të ndërtojnë dhe mbajnë kapacitetin e tyre, me qëllim për të arritur me sukses misionet. Kjo sjellje është në kontrast me vullnetarizmin tradicional, ku vull-





netarët bëjnë diçka tjetër përveç punës së tyre profesionale. Në dekadat e fundit është promovuar edhe vullnetarizmi virtual, i quajtur gjithashtu vullnetarizëm elektronik ose vullnetarizëm online. Vullnetarizmi virtual ka të bëjë me një vullnetar i cili plotëson detyrat, plotësisht ose pjesërisht, jashtë organizatës që asistohet. Ata përdorin internetin dhe një banesë, një shkollë, apo telecentër; kompjuter pune ose pajisje të tjera të lidhura me internet, të tilla si një PDA ose smartphone. Vullnetarizmi virtual njihet gjithashtu si shërbim kibernetik, telementim dhe teletutorim, si dhe mund ta gjejmë me emra të ndryshëm. Vullnetarizmi virtual është i ngjashëm me telekomunikimin, përveç që në vend të punonjësve në internet që paguhen, këta janë vullnetarë në internet që nuk paguhen. A mendoni të bëni vullnetarizëm? Kjo është më shumë se një pyetje, është një çështje në një shoqëri, e cila priret nga ndryshimi dhe zhvillimi dhe si e tillë ka nevojë për vetëdije dhe kontribute qytetare. Vullnetarizmi është një mënyrë e rëndësishme për të ndihmuar individët dhe komunitetet në nevojë dhe, siç shkruan Calvin Holbrook, (një aktivist dhe mentor i vullnetarizmit) përfitimet e këtij akti altruist janë provuar nga shkenca. Me shumicën prej nesh që bëjmë jetë super të

zënë, ideja e vullnetarizmit - duke i dhënë kohë dhe energji një kauze pa shpërblim financiar - mund të duket një detyrë e pamundur.

Dua të them, si mund të fusim ndonjë gjë tjetër në programet tona tashmë të mbushura me bllokime dhe ku gjithçka kërkohet nga shteti ose si të thuash jashtë vetes, përtej kontributit tënd individual apo komunitar?

Sidoqoftë, vullnetarizmi është i rëndësishëm për shumë arsye dhe nuk ka pse të marrë shumë kohë. Në fakt, përfitimet e vullnetarizmit janë të mëdha për vullnetarin dhe jo vetëm për komunitetin, individin ose organizatën që merr ndihmën e tij. Në të vërtetë, janë këto përfitime që mund të shpjegojnë pjesërisht rritjen e popullaritit të vullnetarizmit gjatë viteve të fundit. Gjatë vitit 2012-2013, 29% e të rriturve në Angli, Mbretëri e Bashkuar, thanë se ata kishin dalë vullnetarë zyrtarisht të paktën një herë në muaj. Shifra treguese në Shtetet e Bashkuara nuk është larg, me rreth 25 % (me pak më shumë gra vullnetare se burrat). Me shumë premtime, një numër në rritje i këtyre njerëzve janë të rinj të rritur. Në Mbretërinë e Bashkuar, shifrat tregojnë se 2.9 milion njerëz në grupmoshën 16 deri në 25 vjeç ishin vullnetarë gjatë vitit 2015, krahasuar me 1.8 milion në 2010: kjo është një rritje e madhe.

Vullnetarizmi gjatë pandemisë së Coronavirus (COVID-19)

Ekzistojnë mënyra të ndryshme për të bërë vullnetarizëm gjatë pandemisë së Coronavirus (COVID-19). Sidoqoftë gjëja më e rëndësishme që mund të bëni për të luftuar COVID-19 është të ndiqni udhëzimet për distancimin shoqëror. Kjo do të ndihmojë në kontrollin e virusit dhe në shpëtimin e jetës.

Në çdo vend ka udhëzues specifik se si mund të bëhet puna vullnetare brenda ose jashtë ku rreziku është i pranishëm gjatë pandemisë. Nëse zgjidhni të dilni vullnetar varet nga lloji i aktiviteteve që dëshironi të bëni - dhe rreziqet që lidhen me atë për ju. Kur është e mundur, mund të dilni vullnetarisht duke punuar nga shtëpia. Nëse nuk mund ta bëni këtë, mund të dilni vullnetarisht jashtë shtëpisë tuaj, nëse jeni në gjendje të përmbushni rregulloret dhe udhëzimet e zbatueshme në atë kohë. Informacioni duhet të qartësojë 'kur mund të ndihmoni', 'kë mund të ndihmoni' dhe 'si mund të ndihmoni' duhet të jetë i disponueshëm për individët apo grupet vullnetare. Parimi themelor në kushtet e pandemisë "Covid 19" është: ***"Të qëndrosh i sigurt kur ndihmon të tjerët."*** Nëse dilni vullnetar përmes një organizate, duhet të kontaktoni atë organizatë për

këshilla për të zbuluar nëse është e sigurt për ju të dilni vullnetar. Shumë organizata do të kenë politikat e tyre të vendosura për tu siguruar që ju mund të dilni vullnetarë në mënyrë të sigurtë. Nëse drejtoni një organizatë ose grup vullnetar ose administroni vullnetarë, duhet të lexoni udhëzimet e përgjithshme dhe cilido që përfshihet në këtë veprimtari vullnetare duhet të jetë i mirë trajnuar. Këtë praktikë pune e kemi vënë re me shumë vullnetarë që iu bashkuan urgjencës kombëtare në vendin tonë, veçse në këtë drejtim mund të bëhet edhe më shumë.

* * *

Vullnetarizmi është i frymëzuar nga filozofia e mirësisë dhe ushqehet nga fuqia e mirësisë.

Pse interesi për vullnetarizëm është tregues i një shoqërie të shëndetshme dhe të motivuar? Filozofi grek Aristoteli dikur thoshte se, "thelbi i jetës është "t'u shërbejmë të tjerëve dhe të bëjmë mirë" dhe duket se një numër në rritje njerëzish të të gjitha moshave; kanë filluar të zgjohen dhe të shohin pse vullnetarizmi është i rëndësishëm. Njerëzit kanë filluar të kuptojnë se si shërbimi dhe ndihma ndaj

njeri-tjetrit dhe komuniteteve të ndryshme sjell si realitet që të përfitojnë jo vetëm të tjerët, por edhe ne vetë që shërbejmë. *Vullnetarizmi është i rëndësishëm pasi ofron ndihmë thelbësore për kauza të vlefshme, për njerëz në nevojë dhe komunitetin e gjerë.* Në të vërtetë, shumë organizata vullnetarësh dhe organizata bamirëse mbështeten në zemërgjerësinë e vullnetarëve pasi shpesh ata financohen vetëm përmes këshillave qeveritare ose lokale dhe nuk kanë mundësi të paguajnë pagat për të gjithë stafin e tyre. Në fakt, shumë kompani varen pothuajse vetëm nga ekipe vullnetarësh për t'i ndihmuar ata të lulëzojnë dhe të bëjnë punën e tyre. Pra, cilat janë përfitimet e vullnetarizmit? Sigurisht, përfitimet e vullnetarizmit për ata që marrin ndihmë janë të qarta. Pavarësisht nëse u siguron fëmijëve në një vend të Botës së Tretë mesime falas të gjuhës angleze ose mbledhje mbeturinash nga plazhi i tyre lokal. Përfitimet për marrësin e ndihmës vullnetare dhe komunitetin e gjerë, zakonisht janë pjesë e arsyes pse vendoset të dilet vullnetarë në radhë të parë. *Por a e kemi kuptuar se sa i rëndësishëm mund të jetë vullnetarizmi për personin që e bën atë?* Në fakt, vullnetarizmi është i

dobishëm edhe për vepruesin për një mori të tërë faktorësh ose qoftë edhe për një arsye, duke përfshirë, fjala vjen, zvogëlimin e stresit, apo luftimin e depresionit dhe sigurimin e realizimit të një qëllimi. T'i tregosh tjetrit se nuk je vetëm në kushtet dhe si subjekt apo komunitet në nevojë, se nuk je i harruar, do të thotë që t'i ngjallësh besimin se gjendja jo e mirë apo situata dramatike sociale, ekonomike, ambientale apo arsimore, do të hyjë në rrugën e ndryshimit.

Studimet tregojnë se sa më shumë që punoni si vullnetarë, aq më shumë përfitime do të përjetoni. Vullnetarizmi nuk ka pse të përfshijë një angazhim afatgjatë. Edhe vullnetarizmi në mënyra të thjeshta mund të ndihmojë ata që kanë nevojë por dhe të përmirësojë shëndetin dhe lumturinë tuaj të përgjithshme.

Vazhdon në numrin e ardhshëm.

Përparim Kabo ka lindur në Tiranë në 23 gusht 1954. Kryen studimet e larta në Universitetin e Tiranës në degën e filozofisë të cilat i përfundon me rezultate shumë të larta në vitin 1977. Për më shumë se një dekadë jep mësim, fillimisht për pak vite në arsimin e mesëm, më tej në arsimin e lartë duke u thelluar në punën shkencore. Fillimisht me gradën "kandidat i shkencave" dhe më tej në vitin 1996 "Doktor i shkencave filozofike".

Botimet e tij: "Toleranca, tipar i subjektivitetit të kulturuar", "Shteti ligjor përpara voluntarizmit", "Pa inteligjencën, shoqëria ecën në kahe të kundërt me progresin", "Antropologji pa sistem". "Autoritarizëm në tranzicion".

Përparim KABO është Dekani Fakultetit të Shkencave Psikosociale & Politike në Universitetin Mesdhetar të Shqipërisë.



Teknika e manipulimeve më të shpeshta të ndihmës urgjente mjekësore

Rivendosja e frymëmarrjes dhe veprimtarisë kardiake në rastet me mbytje, strangulim, të goditurit nga korrenti elektrik ose nga rrufeja, nga dielli ose të dëmtuar nga nxehtësia, në traumat me hemorragji të madhe dhe gjendje shoku, në helmimet dhe në disa sëmundje kardiovaskulare, organizmi kërcënohet nga vdekja biologjike për arsye të ndalesës së dy funksioneve kryesore të frymëmarrjes dhe të qarkullimit të gjakut. Vetëm ndërhyrja e menjëhershme e reanimacionit kardiorespirator mund të rivendosë këto dy funksione kryesore dhe të shmangë dëmtimet e pariparueshme të sistemit nervor qendror të cilat ndodhin në 5-12 minutat e para. Frymëmarrja artificiale është masa e parë me të cilën fillon përpjekja për shpëtimin e jetës, ose lufta me vdekjen klinike të porsafilluar. Është e domosdoshme që të sigurohet hyrja e lirë e ajrit në mushkëri. Kjo gjë na detyron të kontrollojmë dhe të pastrojmë rrugët e sipërme respiratore nga lëndët e huaja, të vjellat, gjaku, të lirohet gjoksi nga rrobat që e shtrëngojnë, abdomeni, qafa dhe duart nga çdo gjë që pengon lëvizjen e tyre. Të nxirret gjuha jashtë ose të fiksohet. Frekuenca e frymëmarrjes artificiale duhet të jetë 12 deri në 16 herë në minutë. Ajo duhet të vazhdojë deri sa të arrihet një frymëmarrje spontane me thellësi dhe ritën të mjaftueshëm, me frekuencë normale ose derisa të shfaqen shenjat e sigurta të vdekjes biologjike. Ekzistojnë tri mënyra kryesore të frymëmarrjes artificiale kur nuk disponohet aparate speciale.

1. Frymëmarrja artificiale “gojë më gojë”;
2. “Gojë në hundë”, ose “gojë në tub”;
3. Metoda manuale.

Në mungesë të aparateve të frymëmarrjes artificiale, vecanërisht në kushtet jashtë spitalit, ajo duhet të kryhet duke futur ajrin e ekspiruar të personit që kryen frymëmarrjen artificiale në gojën ose hundën e të dëmtuarit.



Fig. 1-2. Frymëmarrja artificiale sipas mënyrës “gojë më gojë” dhe “gojë në tub”.

Mënyra “gojë më gojë” (Fig. 1 dhe 2) aplikohet në të gjitha rastet kur frymëmarrja është ndërprerë ose është e pamjaftueshme, me përjashtim të rasteve kur buzët, nofullat ose kaviteti i gojës janë dëmtuar rëndë, i sëmurit shtrihet në kurriz, nën shpatulla i vihet një çarçaf i palosur ose ndonjë rrobë dhe koka vendoset në ekstension të theksuar, me qëllim që të zgjerohen rrugët respiratore. Mjeku ose personi tjetër që kryen frymëmarrjen artificiale, ulet në bisht nga njëra anë e kokës

së të dëmtuarit. Me dy gishtërinjtë e njëres dorë kap hundën e të dëmtuarit, duke i zënë vrimat dhe fikson kokën, me dorën tjetër, kap mjekrën dhe hap lehtë nofullën e poshtme, duke e ndarë nga buza e sipërme, Mjeku merr frymë dy herë thellë dhe mbasi përkulet n gjit buzët e veta fort në buzët e të sëmurit duke fryrë me forcë në gojën e të dëmtuarit. Pastaj mjeku largon kokën, liron hundën e të sëmurit ndihmohen edhe duke shtypur me dorën në pjesën e poshtme të kafazit të kraharorit. Ky manipulim përsëritet në mënyrë ritmike 10 deri 12 herë në minutë. Kjo mënyrë e frymëmarrjes artificiale shkakton një ndjenjë jo të këndshëm nga pikëpamje estetike; ajo mund të evitohet duke vendosur mbi gojën e të sëmurit një shami apo disa shtresa gazrash.

Mënyra “gojë më gojë”: aplikohet në të gjitha rastet, përveçse kur hunda ose kaviteti nazal është i dëmtuar. Me këtë metodë hyrja e ajrit në mushkëri bëhet nëpër rrugët e tij normale dhe vetëm një sasi shumë e vogël mund të hyjë në stomak. Pozicioni i mjekuar dhe i të sëmurit është i njëjtë si në mënyrën “gojë më gojë”. Këtu roli i duarve ndryshon në krahasim me mënyrën e parë. Njëra dorë shtrëngon mjekrën në drejtim të nofullës së sipërme, mbyll buzët dhe fikson gojën e të sëmurit, kurse dy gishtat e dorës tjetër kapin hundën nga mezi, duke tërhequr lëkurën e hundës nga baza me qëllim që të zgjerohen vrimat e hundës. Mbas dy inspirimeve të thella, personi që kryen frymëmarrjen artificiale, puthit buzët e veta në hundën e të sëmu-

rit duke fryrë me forcë. Ekspirimi i të dëmtuarit bëhet duke i liruar hundën dhe gojën dhe duke shtypur lehtë pjesën e poshtme të kafazit të kraharorit.

Mënyra “gojë në tub”. Në rastet kur janë dëmtuar kavitetet e hundës dhe të gojës, buzët dhe hunda, frymëmarrja artificiale mund të bëhet edhe nëpërmjet një tubi prej gome të futur në vendin të gojës ose të hundës. Kur kemi hemorragji nga goja ose nga hunda, ajo tamponohet menjëherë pas vendosje së tubit i cili futet deri në fund të hundës, por duhet patur kujdes që tubi mos të hyjë në ezofag, ose të mos shtyjë epiloglotin mbi trake, sepse në të dyja rastet ajri nuk hyn në mushkëri. Që të bëhet ekspirimi i të dëmtuarit duhet që t’i zihet goja dhe hunda me të dyja duart, duke lënë të lirë vetëm tubin . Pas dy inspirimeve të thella, kapet me buzë ana e lirë e tubit dhe fryhet me forcë. Ekspirimi i të dëmtuarit bëhet duke lënë të lirë tubin, buzët dhe hundën dhe duke shtypur lehtë me dorë kafazin e kraharorit (Shiko fig.1 dhe 2)

Metodat manuale të frymëmarrjes artificiale

Janë përshkruar mbi një qind metoda manuale. Duhet të theksojmë se këto metoda janë pak të efektshme për ventilimin pulmonar, shkaktojnë lodhje fizike, etj. Në qoftë se kushtet na detyrojnë të bëjmë frymëmarrje artificiale me duar, atëherë mund të aplikojmë një nga metodat e mëposhtme.

Metoda Schafers’s përdoret në rastet me mbytje. I sëmuri shtrihet



Fig. 3. Respiracioni artificial. Metoda “Schäfer’s”, ekspirimi. Përdoret në rastet me mbytje.

barkas me kokën e mbështetur mbi duart e kryqëzuara përpara. Personi që kryen frymëmarrjen merr një pozicionin të tillë siç tregohet në fig. 3. Ekspirimi i të sëmurit bëhet duke shtypur me të dyja duart mbi dy të treta e poshtme dorsolaterale të toraksit.

Metoda e Sivestrit: I sëmuri shtrihet në shpinë me një jastëk (ose mbështetje tjetër) nën shpatulla. Mjeku ulet në bisht pranë kokës së tij dhe i kap krahët. Për inspirim krahët ngrihen lart dhe prapa (shiko fig.4a), kurse për të ekspiruar ato sillen përpara mbi gjoks duke i kryqëzuar dhe në të njëjtën kohë, duke shtypur mbi pjesën e poshtme të toraksit (shiko fig. 4 b). Metodat e mësipërme apli-




Fig. 4. Frymëmarrja artificiale sipas Silvestrit. Fig. 4a: inspirimi; fig. 4b: ekspirimi

kohen në kushtet kur nuk disponohet më Ambu dhe oksigjen, d.m.th. në kushtet jashtë spitalore.

Aspiracioni i trupave të huaj në rrugët respiratore

Simptomat. Menjëherë shfaqet akcesi i kollës; dispne akute, cianoza. Dëgjohen shumë qartë rale të thata fishkulluese, vecanërisht gjatë inspirimit si stridor inspirator. Respiracioni te pulmonet nuk është i njëjlojtë, ka ulje të tij në pulmonet e bllokuara, invaginacione interkostale lëvizje inverse të respiracionit.

Mjekimi. Në të rriturit me ndër-gjegje të ruajtur: Me shuplakat e dorës jepen goditje midis shpatullave; në rast mossuksesi bëhen ten-

tativa për heqjen e trupave të huaj me klema të veçantë dhe laringoskop. Kur nuk disponohen më këto instrumente ose në rast mossuksesi aplikohet

Dr. Vasil Kuli



Dr. Vasil Kuli

Dy fjalë për Dr. Vasil Kuli

Vasil Kuli ka lindur në Shkodër në vitin 1935. Diplomohet për Mjekësi të Përgjithshme në Akademinë mjekësore të Sofies, Bullgari, dhe specializohet si mjek kardiolog në Fakultetin e Mjekësisë në Tiranë.

Aktivitetin e tij si mjek patolog dhe kardiolog e ka ushtruar në Spitalin Politeknik të rrethit të Lushnjës në periudhën 1960-1997 në pozicione të ndryshme drejtuese deri drejtor i përgjithshëm i Spitalit

Dr. Vasil Kuli ka qenë pedagog i jashtëm në Fakultetin e Mjekësisë në Tiranë (1985-1990) dhe pedagog në Shkollën e Lartë të Infermierisë në Lushnjë (1982-1988).

Në eksperiencën e tij 50 vjeçare si mjek kardiolog dhe patolog ai ka botuar shumë punime në periodikët mjekësor shqiptarë.

Dr. Vasili tij është dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit popullor me urdhëra e medalje.

Roli i pabesueshëm i Lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe gjatë Luftës së II-të Botërore

Roli i Lëvizjes ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe gjatë Luftës së II Botërore vazhdon të mbetet gjerësisht i panjohur për publikun. por rezultatet e veprimtarisë së këtij organizmi humanitar gjithnjë janë vlerësuar. Në zbatim të Konventave të Gjenevës të rishikuara në vitin 1929, Kryqi i Kuq ka marrë pjesë në të gjitha skenat e teatrit të luftës duke angazhuar të punësuar dhe vullnetarë të shumtë, të cilët kanë qenë ata që kanë realizuar veprimtaritë e ndryshme humanitare të kësaj Lëvizje.

Ata kanë ndihmuar të plagosurit në të dyja krahët e luftimit, kanë shërbyer si ndërmjetës në misione të ndryshme diplomatike, kanë vëzhguar trajtimin e robërve të luftës, kanë mbajtur dhe ruajtur lidhjet ndërmjet miliona personave apo të zhvendosurve që kishin humbur lidhjet gjatë luftës. Veprimtaritë e Kryqit të Kuq në konfliktet më të mëdha në histori, në konflikte ku u përdorën armët më moderne me efekte shkatërruese, kanë qenë akte humanitare me mjaft vlerë në një botë të përfshirë nga lufta, dëshpërimi dhe mungesa e shpresës.

Agjencia Qendrore e Informacionit për Robërit e Luftës e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të

Kuq, me bazë në Gjenevë të Zvicrës, KNKK punësoi një staf prej 3000 persona të cilët kanë administruar me kujdes indeksin e kartave, karta që kanë shërbyer për ndjekjen e fatit të robërve të luftës. Ky indeks përmban më shumë se 45 milion karta. Ndërkohë, Agjencia ka shkëmbyer më shumë se 120 milion mesazhe ndërmjet të burgosurve në 41 vende.

Kjo agjenci, në periudhën ndërmjet 1939-1945, ka realizuar gjithashtu 12 750 vizita zyrtare në kampe të ndryshme të robërve të luftës në të gjithë botën. Më shumë se ruajtjen e kontakteve ndërmjet robërve të luftës dhe familjeve të tyre, Kryqi i Kuq ka furnizuar vendet e vuajtjes së dënimit me materiale të ndryshme,

përfshirë këtu ushqime dhe medikamente. Aty ku ka qenë e mundur, ata kanë inspektuar kampet e robërve të luftës për shkelje të mundshme të Konventave të Gjenevës, duke parandaluar kështu viktima të mundshme ndërmjet të burgosurve.

Megjithatë, organizata e ka pasur të pamundur të ndikojë në rezultatin e genocidit më të madh të shkaktuar ndonjëherë – Holokaustin. Rishikimi i Konventave të Gjenevës në vitin 1929 nuk parashikonte zbatimin e këtyre konventave për civilët, sepse në atë kohë nuk mendohej, aq më tepër të parashikohej se lufta e ardhshme do të kërcënonte jetën e viktimave të shumtë jo ushtarakë. Vetëm në vitin 1940, Konventat e



Gjenevës do të përshtateshin dhe për civilët. Mungesa e ushqimit që pllakosi në Evropë gjatë luftës, bëri që të shpërthente një krizë globale humanitare. KNKK arriti të menaxhonte me sukses urinë që kishte pllakosur Greqinë dhe Ishujt Channel.

Në Luftën e Dytë Botërore, viktimat civile e kaluan shumë numrin e viktimave ushtarake. Edhe pse Lëvizja ndërkombëtare e Kryqit të Kuq kishte informacione për deportimet masive të civilëve në kampet e përqendrimi, ajo nuk u lejua të veprojë nga Gjermania naziste. Departamenti gjerman i Kryqit të Kuq ishte tërësisht i infektuar dhe i korruptuar nga nazistët. Ky fakt mbetet një njollë turpi për organizatën dhe rolin e saj në luftë. Kryqi i Kuq Gjerman, i mbështetur nga qeveria naziste mohoi hyrjen e misioneve ndërkombëtare në kampet e vdekjes, duke thënë në mënyrë të turpshme se në rajonet e pushtuara nga ushtria gjermane nuk kishte asnjë shkelje të të drejtave të njeriut.

Kështu, shumë krime lufte poudodhnin duke i mbajtur larg tyre punonjësit e Kryqit të Kuq. Lëvizja ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe ishte pjesërisht e vetëdijshëm për fushatën shfarosëse naziste të drejtuar ndaj popullatës hebreje dhe asaj rome, por për shkak të pretendimit të saj për asnjani dhe të pengesave të tjera administrative, ata vendosën të mos ndërhyjnë. Edhe pse nuk mund të ndalonin vrasjet, ata arritën të marrin leje nga autoritetet naziste në nëntor 1943 për të dorëzuar pako ushqimore për të burgosurit, (në kampet e përqendrimit) emrat e të cilëve ishin të njohur për KNKK-së.

Për shkak se njoftimet e pranimit për këto pako nënshkruheshin shpesh nga të burgosur të tjerë, KNKK arriti të regjistrojë identitetet e rreth 105,000 të arrestuarve në kampe përqendrimi dhe dorëzoi rreth 1.1 milion pako, kryesisht këto



në kampet e Dachau, Buchenwald, Ravensbrück dhe Sachsenhausen. Në mars të vitit 1945 u dha leja për delegatët e Kryqit të Kuq për të vizituar kampet e vdekjes, por me kushtin për të qëndruar atje deri në fund të luftës. Dhjetë delegatë ju përgjigjën pozitivisht thirrjes. Delegatët vizituan Dachau, Mauthausen dhe Theresienstadt.

Louis Haefliger, një nga delegatët e KNKK, parandaloi dëbimin me forcë dhe shkatërrimin e kampit të Mauthausen-Gusen duke njoftuar trupat amerikane dhe shpëtuar në këtë mënyrë jetën e rreth 60,000 të burgosurve. Edhe pse një shkelje e drejtpërdrejtë e pretendimit të neutralitetit të KNKK-së, ky veprim ishte njerëzor dhe duhej bërë. Për shkak të këtij veprimi, delegati u dënua nga KNKK dhe u rehabilitua vetëm në vitin 1990, nga Kryetari i atëhershëm i KNKK z. Cornelio Sommaruga që vuri kështu në vend reputacionin e tij.

Kryqi i Kuq i qëndroi gjithmonë fort parimit të neutralitetit, gjë që në disa raste rezultoi të ishte i gabuar. Megjithatë, organizata arriti të kontribuojë ndjeshëm në përpjekjen e Aleatëve për luftë, edhe pse shërbeu si një fraksion nominalisht neutral. Kryqi i Kuq Amerikan dëshmoi se ishte veçanërisht i përkushtuar, duke u angazhuar në luftë që në vitin 1939, dy vjet para se SHBA t'i shpallte zyrtarisht luftë Fuqive të Boshtit. Duke vepruar me 6 milion vullnetarë, Kry-



qi i Kuq Amerikan ishte në vijat e para të luftës në të gjithë botën.

Aktet e vogla të mirësisë ndihmuan ushtarët t'i mbijetonin tmerrin e luftës. Veçanërisht robërit e luftës kanë shumë për të falënderuar Kryqin e Kuq, që pavarësisht këtyre përpjekjeve jo çdo gjë dhe jo gjithnjë ka shkuar mirë për ta. Japonia dhe Bashkimi Sovjetik nuk i nënshkruan Konventat e Gjenevës të vitit 1929, dhe për këtë arsye atyre me ligj nuk mund t'u kërkohej të respektonin rregullat e tyre.

Pas luftës, Kryqi i Kuq u nderua më Çmimin Nobel për Paqen, pikërisht për veprimtarinë e tij ndërmjet viteve 1939-1945.

** Nicola Budanovic është një gazetar i lirë që ka punuar për media të ndryshme si Vice, War History Online, The Vintage News, Taste of Cinema, etj. Ai kryesisht ka shkruar për tema të tilla si historia ushtarake dhe historia në përgjithësi, historia e filmit dhe e letërsisë.*

Përgatiti për botim:

Zamir Muça

<https://www.warhistoryonline.com/author/nikola-budanovic>

Veprimtaritë e Kryqit të Kuq Shqiptar

1 shtator

Pavarësisht se situata prej pandemisë ka kushtëzuar jetën tonë të përditshme me kufizime të domosdoshme për shëndetin, vullnetarët e degës janë gjendur pranë pushuesve në bregdet! Fletëpalosje e demonstrime për Ndhimën e Parë, për shëndetin, por edhe këshillime mbi distancimin fizik ishin pjesë e veprimtarive të zhvilluara gjatë sezonit veror.

11 shtator

Tirana Bank dhuron 100 çanta dhe kite shkollore për fëmijët në nevojë! Dega e Kryqit të Kuq Tiranë me mbështetjen e Tirana Bank organizoi një aktivitet të veçantë për shpërndarjen e çantave dhe mjeteve shkollore për 100 fëmijë jetimë dhe të familjeve në nevojë. Faleminderit Tirana Bank për kontributin tuaj dhe për mbështetjen e vazhdueshme për njerëzit në nevojë. Gëzuar vitin e ri shkollor për të gjithë fëmijët dhe suksese në mësim!

12 shtator

Dita Botërore e Ndhimës së Parë. Në shumë degë të Kryqit të Kuq Shqiptar u zhvilluan veprimtari sensibilizuese mbi rëndësinë e dhënies së Ndhimës së Parë. Veprimtaritë u organizuan në bashkëpunim me Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe Emergjencat Civile!

29 shtator

Punonjësit e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural dhuruan

gjak vullnetarisht në ambientet e Selisë së Kryqit të Kuq Shqiptar. Prej disa kohësh, pikërisht këto ambiente po bëhen një qendër e rëndësishme mikpritëse për të gjithë ata që duan të dhurojnë gjak vullnetarisht për fëmijët talasemikë dhe për të gjithë ata që kanë nevojë.

3 tetor

Kryqi i Kuq Shqiptar, dega Tiranë, vazhdon të shpërndajë pako ushqimore për familjet më në nevojë të kryeqytetit. Vullnetarët kanë realizuar shpërndarjen e ndihmave për 60 familje në vështirësi nga zona të ndryshme të Tiranës.

11 tetor

Në instalacionin "Reja" pranë Galerisë Kombëtare të Arteve u zhvillua takimi gjysmë final i Konkursit të VI-të Kombëtar për vlerat humanitare "Rinia dhe Kryqi i Kuq". Pjesëmarrës në këtë fazë ishin ekipet e vullnetarëve të Degëve të Kryqit të Kuq Tiranë, Durrës, Vlorë, Elbasan, Lezhë, Pogradec, Lushnje dhe Kuçovë. Këtë veprimtari e nderoi me pjesëmarrjen e tij Ish Presidenti i Republikës, z. Alfred Mojsiu dhe Presidenti i Kryqit të Kuq Shqiptar z. Ylli Alushi.

13 Tetor

Në Ditën ndërkombëtare të ndërgjegjësimit të komunitetit për zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë, Degët e Kryqit të Kuq Shqiptar në të gjithë vendin zhvilluan veprimtari sensibilizuese, veçanërisht në shkollat 9-vjeçare dhe ato të mesme si dhe për publikun e gjerë.

17 Tetor

Në Ditën Botërore kundër Urisë, Big Market ndihmon 150 familje në nevojë me pako ushqimore dhe detergjentë! Faleminderit Big Market për bashkëpunimin me Kryqin e Kuq Shqiptar dhe që merrni pjesë në aktivitetet tona humane duke ndihmuar këdo që ka nevojë. Duke punuar të gjithë së bashku ne mund të krijojmë një rrjet të madh mbështetjeje për çdo njeri që ndodhet në momente të vështira.

31 tetor

Ekipet e Gjysmëhënës së Kuqë Turke janë në terren për të ndihmuar popullsinë në nevojë, për shkak të tërmetit të fuqishëm të shkallës 6.6 që goditi brigjet e Turqisë dhe veriun e ishullit grek të Samosit. Ata kanë mobilizuar një ekip për të shpërndarë ushqime të mjaftueshme për më shumë se 25,000 persona në nevojë.

5 dhjetor

Në ditën ndërkombëtare të vullnetarizmit, të rinjtë vullnetarë organizuan takime online. Vullnetarët ndanë përvojat dhe emocionet e tyre në veprimtaritë e organizuara prej vetë atyre.

12 dhjetor

Programi i Mbështetjes Psikosociale zhvilloi një seri trajnimesh online mbi COVID-19. Këto trajnime u fokusuan në dhënien e informacionit për COVID-19, njohjen e protokolleve për mbështetjen psikosociale, promovimin e Linjës së Gjelbër telefonike (Greenline) dhe kontributin e dhënë nga Kryqi i Kuq Shqiptar

në situatën e krijuar nga pandemia Covid-19.

18 dhjetor

Degët e Kryqit të Kuq Shqiptar vazhdojnë mbështetjen e familjeve në nevojë. Në një nga këto shpërndarje të organizuara në Degën e Kryqit të Kuq Vlorë, në Nartë ka marrë pjesë dhe Ambasadori i Austrisë Dr. Christian Steiner dhe Presidenti i Kryqit të Kuq Shqiptar Z. Ylli Alushi. Mbështetja do të vazhdojë!

21 dhjetor

Në molin "Henry Dunant" tek liqeni artificial i Tiranës, u organizua ekspozita fotografike me momente nga puna e vullnetarëve tanë gjatë këtij viti. Ekspozita u organizua në bashkëpunim me Agjencinë e Parqeve dhe të Rekreacionit.

23 dhjetor

Vullnetarët e talentuar të degës Tiranë përfaqësojnë denjësisht Kryqin e Kuq Shqiptar në Festivalin e këngës në RTSH! Të ftuar në natën e dytë të këtij festivali, vullnetarët e degës së Kryqit të Kuq Tiranë prezantuan veprimtaritë e realizuara nga shoqata.

24 dhjetor

Në pragun e festave të fundvitit u zhvillua seanca e rradhës e dhurimit vullnetar të gjakut në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Pronësisë Industriale.

31 dhjetor

Gëzuar Vitin e Ri të gjitha familjeve shqiptare!

Në prag të Vitit të Ri 2021 jemi pranë familjeve më në nevojë të kryeqytetit. Falë bujarisë së Credins Bank me dhjetëra familje do të kenë diçka për të shtruar sot në tryezat e tyre në darkën e ndërrimit të viteve.

Dr. Idriz Tali (1940 - 2020)



Është ndarë nga jeta në moshën 80 vjeçare dr. Idriz Tali.

Dr. Idriz Tali, lindi më, 5 janar 1940 në Fushë Krujë. Pas përfundimit të Shkollës së Mesme në Krujë, ai kryen studion në Fakultetin e Mjekësisë, dhe në vitin 1974 specializohet në Dermatologji.

Kontributi i Dr. Idriz Tali shtrihet në një periudhë të gjatë kohore, fillimisht si mjek i përgjithshëm në qendrën shëndetësore Fushë Krujë e më vonë për shumë vite si Shef i seksionit të shëndetësisë të rrethit Krujë; Përgjegjës i spital/poliklinikës së qytetit Krujë; si mjek epidemiolog në qendrën sanitare të rrethit Krujë; e në fund si Drejtor i Shëndetit Publik të rrethit Krujë. Megjithëse në pension pleqërie, në vitin 2001, Dr. Idrizi vazhdoi të kryente punën e tij në specialitetin e dermatologjisë, duke i shërbyer pacientëve në nevojë.

Një kontribut të vyer vullnetar, Dr. Idrizi ka dhënë në Kryqin e Kuq Shqiptar. Në një periudhë të gjatë kohore, 1995 deri 2013, ai zgjidhet:

- Kryetar i Degës së Kryqit të Kuq Krujë;
- Anëtar i Këshillit Drejtues të Kryqit të Kuq Shqiptar;

- Kryetar i komisionit të Kontroll Verifikimit të Kryqit të Kuq Shqiptar.

Kontributi i tij në shoqatën më të madhe të vendit, ka qenë i padiskutueshëm. Ka qenë gjithmonë në krah të njerëzve në nevojë, në kohë të vështira që ka kaluar vendi. Megjithëse vitet e fundit ishte i pamundur për të marrë pjesë me veprimtaritë konkrete, ai gjithmonë interesohej për situatën në fushën e mjekësisë dhe të ecurisë së punëve në Kryqin e Kuq. Dr. Idriz Tali është dekoruar 2 herë me medaljen për shërbim të mirë ndaj popullit. Në vitin 2009, ka marrë titullin "Qytetar Nderi" nga Bashkia e Fushë Krujës.

Dr. Idrizi, do mbetet në kujtesën e shumë gjeneratave për urtësinë, këshillat, fisnikërinë, dashamirësinë dhe përvojën e tij organizuese, me karakterin e fortë që e karakterizonte, për humanizmin, devotshmërinë dhe përkujdesen e pafund që tregoi një jetë të tërë, në shkallë rrethi dhe në drejtimin e spitalit të rrethit Krujë.

Respekt dhe mirënjohje për Dr. Idriz Tali!
I paharruar kujtimi i tij!

Viti 2020, si asnjë vit tjetër

vijon nga faqja 3

ka bërë më kohë zgjedhjen, pasojat e fatkeqësive ajo përpiqet t'i sfidojë me përpjekjet e përkushtimit të saj.

Shoqata arriti të orientohet në situatën e krijuar duke u njohur me gjendjen e grupeve shenjë dhe që në ato momente ishin kryesisht familjet e dëmtuara nga tërmeti, familjet e varfëra, individët e moshuar e të vetmuar, etj., të cilët edhe në situata normale përballen me vështirësi mbijetese.

Aksioni kryesor humanitar i shoqatës do të përqëndrohej në dy drejtime: në ndihmën ekonomike dhe në përhapjen e informacionit të nevojshëm për kujdes shëndetësor në mënyrën më të thjeshtë për t'u kuptuar nga ana e komunitetit, ndërkohë që vëmendja u përqëndrua në marrjen e masave për të ruajtur shëndetin e vullnetarëve dhe punonjësve nga mundësia e infektimit.

Kështu, gjatë gjithë muajve deri në fund të vitit shoqata arriti të ndihmojë me mijëra familje në nevojë me artikuj ushqimorë dhe higjienikë. Është vendi për të përmendur aksionin 6-të mujor të shpërndarjes së ndihmave në lekë për 1100 familjet më të varfëra. Ndërkohë, paralelisht dhe në mënyrë të pandërprerë ka vazhduar informimi i mbarë komunitetit nëpërmjet publikimit të informacionit mbi masat për t'u mbajtur parasysh dhe vënë në jetë, duke demonstruar elementet e ndryshimit dhe përshtatjes ndaj realitetit të ri të imponuar e të jetuarit të komunitetit.

Informimi mbarë shoqëror ka qenë një kontribut shtesë që shoqata ofroi gjatë gjithë vitit dhe synimi kryesor i tij ishte zvogëlimi i numrit të infektiveve në njësinë e kohës, duke kontribuar në këtë mënyrë në dhënien e mundësisë së sistemit shën-

detësor të ofrojë shërbimin mjekësor për më të rënduarit, ndërkohë që ndërprerja e zinxhirit të infektiveve do të ishte arritja ideale në planin e përgjithshëm të luftës ndaj virusit por, mesa u pa, kjo do të arrihej vetëm pas zbulimit të vaksinës dhe arritjen e imunitetit të masës. Efektet pozitive të këtij kontributi të shoqatës mund të mos mësohen kurrë por shoqata kështu ka vepruar ngaherë, duke kontribuar në interes të nevojtarëve në vend pa i dhënë rëndësi marrjes pas të ndonjë merite. Periudha një vjeçare e luftës ndaj pandemisë po shoqërohej me njohuri të reja rreth pasojave që ajo po sillte. Përmendim faktin se imuniteti i të shëruarve nuk zgjat më shumë se disa muaj dhe riinfektimi është tashmë realitet, ndonëse jo tek të gjithë.

Kjo do të thotë që lufta ndaj virusit do të vazhdojë deri sa ai të pësojë atë lloj mutacioni që të mundësojë bashkekzistencën me njeriun duke zvogëluar në këtë mënyrë aftësinë e tij për infektimin masiv njëherazi të popullatës si pasojë ose njeriu të mundësojë përshtatjen e tij me këtë realitet të ri.

Ndërkohë ende nuk dihet sa kohë zgjat mbrojtja që ofron vaksina por si provë të kësaj faze fillestare ka dhënë uljen e përqindjeve të numrit të të infektuarve. Këto janë mësuar në linja të përgjithshme deri tani. Mbështetur në këto njohuri shoqata vazhdoi të bëjë një fushatë intensive informimi për publikun e gjerë vetëm, por dhe krahas me strukturat e shëndetit publik apo dhe në koordinim me Delegacionin rajonal të Federatës Ndërkombëtare të Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqë.

Por shoqata kurrësi nuk mund



ti lejonte vetes ndërprerjen e aktiviteteve të tjera, të planifikuara për t'u realizuar, kuptohet duke mbajtur parasysh dhe respektuar me rigozitet rregullat për t'u ndjekur të higjienës dhe të distancimit fizik. Natyrshëm, jo të gjitha aktivitetet ishin të mundura të realizoheshin me të njëjtën pjesëmarrje dhe me të njëjtin numër përfituesish. Sidoqoftë, realizohej prezenca e shoqatës në komunitet, një tregues ky i rëndësishëm për identifikimin e punës së saj.

Kështu, konkursi i vlerave humanitare në nivel lokal, promovimi i dhurimit vullnetar të gjakut, kurset e ndihmës së parë e trajnimi për lidershipin, etj., u zhvilluan online.

Për një numër veprimtarish, duke filluar që nga mbajtja e mbledhjeve të organeve të zgjedhura dhe duke vazhduar me aktivitete të ndryshme me pjesëmarrjen e vullnetarëve, u veprua nëpërmjet kontakteve virtuale si një mënyrë e re ad operandi që u përdor jo vetëm nga shoqata jonë por që gjeti përdorim global.

Përvoja e fituar nga shoqata gjatë aksionit humanitar në përpjekjet për të lehtësuar pasojat e tërmetit dhe të pandemisë përbëjnë një eksperiencë të re dhe të vyer për të, duke e bërë atë më të pjekur, më të aftë, më humane, më të fortë, më të ndjeshme ndaj njerëzve në nevojë, duke e bërë atë të ndjehet krenarë që edhe në këto situata të vështira ishte prezentë në komunitet në përmbushje të misionit të saj fisnik gjithmonë në ndihmë të tij.

Magj. Ylli Alushi

President i Kryqit të Kuq Shqiptar

Lëvizja Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe e Gjysmëhënës së Kuqe në të cilën bën pjesë edhe Kryqi i Kuq Shqiptar, përfshin tre përbërës: Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK), Federatën Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe (Federata Ndërkombëtare) dhe Shoqatat Kombëtare.



Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) si organizatë e paanshme, neutrale dhe e pavarur, ka misionin e posaçëm humanitar për të mbrojtur jetën dhe dinjitetin e viktimave të luftës dhe të dhunës së brendshme si dhe për t'u dhënë atyre ndihmë. Ai drejton dhe koordinon aktivitetet ndërkombëtare të ndihmës së gjithë Lëvizjes, në situatat e konflikteve. Përpiqet gjithashtu që të parandalojë vuajtjen njerëzore nëpërmjet promovimit dhe sigurimit të zbatimit të së drejtës dhe parimeve humanitare universale. I krijuar më 1863, KNKK-ja është në origjinë të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe. Ai e ka njohur Kryqin e Kuq Shqiptar, në vitin 1923.

Federata Ndërkombëtare e Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe, anëtar i së cilës është dhe Kryqi i Kuq Shqiptar që nga viti 1923, i përkushtohet sipas Parimeve themelore të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, frymëzimit, favorizimit dhe promovimit të aktiviteteve humanitare të zhvilluara prej Shoqatave Kombëtare me qëllim përmirësimin e gjendjes së njerëzve më në nevojë. E themeluar më 1919, Federata Ndërkombëtare drejton dhe koordinon ndihmën ndërkombëtare të Lëvizjes për viktimat e katastrofave natyrore apo teknologjike, për refugjatët dhe për rastet e situatave të jashtëzakonshme shëndetsore. Ajo inkurajon bashkëpunimin mes Shoqatave Kombëtare dhe përpiqet që të forcojë kapacitetin e tyre për realizimin e programeve efikase në fushat e përgatitjes për ndërhyrje në raste katastrofash, shëndetit dhe ndihmës sociale.

Shoqatat Kombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe (një prej të cilave është dhe Kryqi i Kuq Shqiptar) vënë në jetë qëllimet dhe parimet e Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe në 191 vende të botës. Ato përmbushin në vendet e tyre respektive, rolin e ndihmësit të pushtetit publik për gjithçka lidhet me çështjet humanitare dhe kryejnë veprimtari në fusha të tilla si: ndihma në rastet e katastrofave, shërbimet në sektorin e shëndetit dhe ndihma sociale. Në raste lufte, ato i japin ndihma popullsisë civile të prekur prej saj dhe u ofrojnë mbështetje shërbimeve shëndetsore të ushtrisë.

Të gjithë përbërësit e Lëvizjes Ndërkombëtare e Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe udhëhiqen nga shtatë parimet themelore:

humanizmi, paanësia, asnjëanësia, pavarësia, vullnetarizmi, uniteti dhe universaliteti

NGA ARKIVAT E KOHËS

FLETORJA E KRYQIT TË KUQ SHQIPTAR

ORGAN INFORMATIV I PËRJAVËSHEM I INSTITUTIT BAMB

Vol. I No 1 - Janar 1917-1918 Zyra e Administratës: në Qendrën e Kryqit të Kuq - Tiranë Çmimi: 1000 Lira

ORIGJINA DHE THEMELIMI I KRYQIT TË KUQ

Historia e Kryqit të Kuq shqiptar është një histori e gjatë dhe e rëndësishme. Ajo fillon në vitin 1912, kur u krijua Komiteti i Kryqit të Kuq shqiptar në Tiranë. Ky komitet u themelua nga një grup patriotësh të rinj, të cilët kishin për qëllim të shpërndanin ndihmë dhe shërbime mjekësore për popullin shqiptar gjatë Luftës së Parë Botërore.

Qëllimi i kryesisht ishte të ofrohej ndihmë mjekësore dhe shërbime të tjera të nevojshme për ushtrinë dhe civilin. Komiteti u bashkoi me Komitetin e Kryqit të Kuq të Evropës dhe u bashkoi me Komitetin e Kryqit të Kuq të Ballkanit. Kështu, Komiteti shqiptar bëri pjesë në një rrjet global të shërbimeve të Kryqit të Kuq.

Programi i Fletorisë

Programi i Fletorisë është një dokument i rëndësishëm që përcakton qëllimet dhe detyrat e Kryqit të Kuq shqiptar. Ky program u miratua nga Komiteti i Kryqit të Kuq shqiptar në vitin 1917.


Qëllimet kryesore të kësaj fletorisë janë të përcaktuara në mënyrë të qartë. Ato përfshijnë: të ofrohet ndihmë mjekësore dhe shërbime të tjera të nevojshme për popullin shqiptar gjatë Luftës së Parë Botërore; të promovohet shërbimet e Kryqit të Kuq në tërësi dhe të bashkohet me Komitetin e Kryqit të Kuq të Evropës dhe të Komitetin e Kryqit të Kuq të Ballkanit.

NJE ÇUDI PA SHOQE NE BOTE

Kryqit i Kuq shqiptar i atribuohet një sukses i jashtëzakonshëm gjatë Luftës së Parë Botërore. Ky sukses u arritë në mënyrë të çuditshme dhe pa shokë në botë.

Shërbimet e Kryqit të Kuq shqiptar ishin të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe të shpejtë. Kështu, Komiteti shqiptar bëri pjesë në një rrjet global të shërbimeve të Kryqit të Kuq.

Shërbimet e Kryqit të Kuq shqiptar ishin të përcaktuara në mënyrë të qartë dhe të shpejtë. Kështu, Komiteti shqiptar bëri pjesë në një rrjet global të shërbimeve të Kryqit të Kuq.



NDIHMË PËR KRYQIN E KUQ TË SHQIPËNISË



Momente nga veprimtaria e Kryqit të Kuq gjatë Luftës së II-të Botërore.